

VENDIM
Nr. 564, datë 24.6.2015

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË
TË PRONËS SË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË NDODHUR NË ZONËN
KADASTRALE 8591, PËR NGRITJEN E NDËRTESES SË RE TË GJYKATËS SË
RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të truallit me sipërfaqe 2 000 (dy mijë) m², të ndodhur në zonën kadastrale 8591, sipas formularit dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi, që do të shërbejë për ngritjen e ndërtesës së re të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
 2. Ministrisë së Drejtësisë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
 3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Bashkia Shkodër										
Fusha e përdorimit të pronës: Administrative										
Nr. rendor	A			B			C			
	Zona Kadastrale dhe indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës Adresa	Sip. totale e pronës (m²)	Nga sip. totale sa ndërtues (m²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
858	8591 P-5	4/211	Truall	Rruga “Ethem Osmani”	1270		Shesh për ndërtimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Shkodër			
858/1	8591 P-5	4/212	Truall	Rruga “Ethem Osmani”	178		Shesh për ndërtimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Shkodër			
858/2	8591 P-5	4/298	Truall	Rruga “Ethem Osmani”	552		Shesh për ndërtimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Shkodër			

